

## Shtojca 14

*Autoriteti Kontraktor Sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Vlore*  
**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

06.02.2017

Për: Operatorin ekonomik “**STE-LA 2000**” sh.p.k, me nr.nipti K12518401O, me Administrator Gjergji Stefanidhi, me adrese: Lagjja “Sheq i Madh” Ndërmarrja “Arbëria” rruga Teodor Muzaka, Fier.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim. Nr.REF-65063-01-10-2017.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Zëvendësimi i tubove te ujësjiellësit D=200mm çelik dhe D=225 mm gize me tubo te reja ne rrugën e re nga Akademia te 7 pallatet”.

Fondi limit: 7 705 700 (shtatëmilione e shtatëqind e pese mijë e shtatëqind) leke pa TVSh.

Data e zhvillimit te tenderit: dt. 20/01/2017 Ora: 10:00 Vendi: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

Afati për realizimin e punës: Nga momenti i lidhjes se kontratës, me përfundim deri ne 30 (tridhjetë) dite.

Burimet e financimit: Sh.A Ujësjiellës-Kanalizime Vlore.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [dt.16.01.2017] [Nr.2]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, sipas raportit përfundimtar te KVO te miratuar nga Titullari i AK, ka qenë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, këta ofertues me vlerat përkatëse te ofruara:

1. “ARBERIA”sh.a me ofertë ekonomike 7.673.200 lekë pa tvsh
2. “BOSHNJAKU B” sh.p.k me ofertë ekonomike 7.154.291 lekë pa tvsh
3. “COLOMBO” sh.p.k me ofertë ekonomike 7.690.000 lekë pa tvsh
4. “ELIRA” sh.p.k nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
5. “STELA 2000” sh.p.k me oferte ekonomike 7.280.530 lekë pa tvsh

-Pas mbarimit te vlerësimit, janë shkualifikuar sipas arsyeve përkatëse ofertuesit e mëposhtëm:

**1.Arbëria shpk.** Operatori ekonomik nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, kriteret e veçanta te kualifikimit ,kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe kapacitetin teknik të kërkuar për këtë procedurë.

**2. Elira shpk.** Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike si edhe nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe kapacitetin teknik të kërkuar për këtë procedure.

**3.Colombo shpk.** Operatori ekonomik nuk ka mundur të vërtetojë pikën 1.a të kapacitetit teknik ku kërkohen punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlere jo më pak se 50 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit. Kontrata punë e ngjashme e paraqitur nga operatori ekonomik mban

datën 18.12.2012 dhe sipas Formularit të vlerësimit pra afati I përfundimit të punimeve mban datën 20.05.2013 dhe si e tillë është e pavlefshme pasi kjo kontratë nuk është realizuar gjatë 3 viteve të fundit.

Operatori ekonomik nuk ka mundur të vërtetojë pikën 6 të kapacitetit teknik ku kërkohet të ketë në stafin e punonjësve 1 elektromekanik I cili duhet të jetë edhe në listëpagesa sipas profesioneve përkatëse. Elektromekaniku operatorit ekonomik Dalip Gjonaj nuk rezulton në listëpagesat e firmës për vitin 2015 si edhe periudhën Janar-Gusht 2016.

**4. Boshnjaku shpk.** Operatori ekonomik nuk ka mundur të vërtetojë pikën e) të Kriteret e veçanta të kualifikimit ku duhet të dorëzojë Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të ujit të pijshëm të kontratave të ujit të pijshëm që ka operatori ekonomi që është regjistruar në Shqipëri. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë këtë pikë.

Operatori ekonomik nuk ka mundur të vërtetojë pikën 6 të kapacitetit teknik ku kërkohet të ketë në stafin e punonjësve 1 elektromekanik. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dëshmi që ka të punësuar një elektromekanik në stafin e punonjësve.

Operatori ekonomik nuk ka mundur të vërtetojë pikën 9 të kapacitetit teknik ku thuhet se: Në datën 18/1/2017 në orën 12 do të zhvillohet një takim në Sh.a UK Vlore për tu njohur me natyrën specifike të punimeve, që do të kryen për shkak të ndërprerjes së ujit gjatë lidhjeve dhe lënies së qytetit pa ujë 24 orë. Në përfundim të takimit pjesëmarrësit e interesuar do të pajisen me vërtetimin. Mos paraqitja e vërtetimit në tender do të jetë kusht skualifikues. Operatori ekonomik nuk është paraqitur në datën dhe orën e caktuar për tu pajisur me këtë vërtetim.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për mjetet e pajisje teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës përkatësisht: Palankola PU 12 = 50 cope. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për këtë mjet si edhe asnjë foto për këtë mjet.

-Është kualifikuar vetëm operatori ekonomik **“STE-LA 2000” sh.p.k**, me nr.nipti K12518401O, me oferte ekonomike 7 280 530 (shtatemilion e dyqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh. Ky operator është paraqitur në tender me të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor në Dokumentet Standarde të Tenderit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **“STE-LA 2000” sh.p.k**, me nr.nipti K12518401O, me Administrator Gjergji Stefanidhi, me adresë: Lagjja “Sheq i Madh” Ndërmarrja “Arbëria” rruga Teodor Muzaka, Fier, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7 280 530 (shtatemilion e dyqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa tvsh., /pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë (sekretarisë) së Autoritetit Kontraktor Sh.A Ujësjetës-Kanalizime Vlore Lagjja: “Kushtrimi” Rruga: “Arkobaleno”, me një zarf të mbyllur dhe të vulosur, sigurimin e kontratës në vlerën 10% me tvsh të ofertës tuaj, dhe dokumentet e tenderit të listuara me flete inventar, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi. Pasi të

verifikohet dokumentacioni nga KVO, ju do te njoftoheni me telefon për te nënshkruar kontratën.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, Autoriteti Kontraktor Sh.A UK Vlore do te procedoje siç parashikohet në nenin 58 dhe 24 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit përfundimtar është bere ne dt.27.01.2017 ne faqen zyrtare te APP-se.

Ankesa: ka ose jo, JO ne ketë procedure prokurimi s’ka patur ankesa nga operatoret ekonomik:

(nëse ka) ka marre përgjigje ne date: \_\_\_\_\_

Dorian Xhelili

\_\_\_\_\_  
Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor

